



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.148 dt.29.09.1997

**PER DHENIE FOND PAGE NDERMARRJES SE PRODHIMIT
“ENE BAKRI”.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.29.09.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik sektori i Industrisë “Për dhënie fond page gjatë periudhës së likujdimit të ndërmarrjes prodhim Enë Bakri”, mbështetur në ligjin “Për organizimin e pushtetit lokal”, Nr.7592, dt.10.06.1992, duke zbatuar vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.589, dt.16.10.1995, pika.4, nëndarja.7,

VENDOSI

1. Ndërmarrjes së prodhimit të Enëve të Bakrit ti jepet fondi prej 131.526.8 lekë për pagesën e likuidatorit, shefit të financës, specialistit, magazinierit dhe rojeve.
2. Pagesat të fillojnë nga dt.16.07.1997 për periudhën deri 45 ditë për likujdimin e ndërmarrjes.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

